



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1333/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha, kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesën e Aleksandar Petroviq në cilësinë e Kandidatit për Anëtar Kuvendit Komunal të Gjilanit nga radhët e subjektit politik Za Evropsko Gnjilane , paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të publikimit të rezultateve përfundimtare, në seancën e panelit të mbajtur me 27.12.2013, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuara ankesa e Aleksandar Petroviq nga radhët e subjektit politik Za Evropsko Gnjilane.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 24.12.2013, nëpërmjet PTK-së të parashtruar në këtë postë me datën 03.12.2013 nga Aleksandar Petroviq në cilësinë e kandidatit për anëtar kuvendit komunal të Gjilanit nga radhët e subjektit politik Za Evropsko Gnjilane në të cilën thekson se në bazë të formularëve për përputhjen e rezultateve të kandidatëve në vendvotimin 0420D/01D në fshatin Ponesh komuna e Gjilanit i ka pasur 7 vota e tani në bazë rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja i ka zero vota, në vendvotimin 0434D/01D në fshatin Livoq i Epërm ka pasur 5 vota në listën e paraqitur në shkollë ndërsa në rezultatin përfundimtar del se i ka fituar 3 vota. Andaj me këtë parashtruesi i ankesës kërkon që të përmisohen rezultatet e fituara nga vendvotimet e lartcekuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

## **Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet ankimore nga ana e Aleksandar Petroviq se i mungojnë votat, PZAP-i konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar në prova dhe në dëshmi bindëse pasi që parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur prova për tu vërtetuar pretendimet e tilla ankimore dhe me këtë rast nuk është arritur që për asnjë moment që të vërtetohen pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë. Andaj PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 1333/2013 më datën 27.12.2013.



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.